




Delivering
the Power of
Being Understood

RAPORTI I TRANSPARENÇËS 2021

RSM KOSOVO SH.P.K

THE POWER OF BEING UNDERSTOOD
AUDIT | TAX | CONSULTING





A world leader
in audit, tax and
advisory services.

PËRMBAJTJA

	Faqe
Mesazh nga Partneri Menaxhues	5
Struktura ligjore dhe pronësia	6
Rrjeti i RSM International	10
Sistemi i kontrollit të brendshëm- Rishikimi i sigurimit të cilësisë	12
Edukimi i vazhdueshëm profesional, rekrutimi dhe zhvillimi personal	14
Kompensimi i partnerëve	15
Auditimi i subjekteve me interes publik	16
Shënimet financiare	17
Shtojcat	19

A professional man with dark hair and a beard, wearing glasses, a white shirt, and a red patterned tie, is gesturing with his right hand while speaking. He is positioned on the right side of the frame, with a large, semi-transparent callout box to his left containing text.

Strong collaborative
relationships based
on a genuine
understanding

Mesazh nga Partneri Menaxhues


RSM Kosovo Sh.p.k me kënaqësi paraqet Raportin e Transparencës për vitin financiar që përfundoi më 31 dhjetor 2021 i cili është përgatitur në përputhje me kërkesat e nenit 10 të Ligjit Nr. 06 / L-032 për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim i publikuar në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës nr. 3 i datës 19 Prill 2018.

Ky raport është një deklaratë publike për të gjithë akterët e angazhimit përfshirë klientët, rregulatorët dhe publikun e gjerë në lidhje me përpjekjet tona për të pasur njerëz, kornizë, politika, procedura dhe teknologji të nevojshme për të realizuar auditime dhe sherbime të tjera me cilësi të lartë për klientët në Republikën e Kosovës.

Ju mund të zbuloni më shumë në lidhje me bindjet tona thelbësore të kuptimit, bashkëpunimit si besime thelbësore për Fuqinë e të kuptuarit në të cilat janë mbështetur vlerat tona të përbashkëta globale të respektit, integrititetit, punës ekipore, përsosmërisë dhe menaxhimit në këtë raport. Raporti sqaron se si funksionon Kompania, si sigurohemi që të ofrojmë shërbime profesionale të auditimit të cilësisë më të lartë në mënyrë objektive dhe etike dhe përshkruan ekspertizën, gjerësinë dhe thellësinë e Kompanisë dhe të RSM International.

Përderisa ky është viti i dytë që publikojmë raportin tonë të transparencës, ky është përvjetori ynë i pestë me brendin RSM. Ne jemi të kënaqur që formojmë një rrjet të fortë dhe pionier i cili operon si një 'brend i unifikuar global', duke siguruar që klientët të përfitojnë nga njohuritë e përbashkëta dhe praktikat më të mira kudo që bëjnë biznes, si dhe të jenë në gjendje të mbështeten në përvojën dhe mirëkuptimin vendor cilësor.

Ndërsa shumë gjëra rreth nesh janë duke ndryshuar, një gjë në RSM mbetet konstante: përkushtimi ynë për të dhënë fuqinë e të kuptuarit për klientët, kolegët dhe komunitetet tona. Ne besojmë se duke marrë kohë për të kuptuar me të vërtetë të tjerët dhe aspiratat e tyre, ne jemi në gjendje të jemi një ofrues shërbimi dhe punëdhënësi i zgjedhjes së parë që i ndihmon të tjerët të arrijnë potencialin e tyre të plotë. Ne mirëpresim që vitin e ardhshëm të punojmë me klientët tanë dhe palët me interes brenda komunitetit tonë.



Visar Morina
Partner Menaxhues
RSM Kosovo Sh.p.k

30 Prill 2022
Prishtinë, Republika e Kosovës



1. Struktura Ligjore dhe Pronësia

RSM Kosovo SH.P.K. ("Kompania") është shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e regjistruar në Republikën e Kosovës më 18 Prill 2016 me numër unik identifikues 810861254. Adresa e regjistruar e selisë është Rruga Xhevdet Doda Dukagjini Residence, Hyrja B-C, Kati 2, nr. B56, Prishtinë, Republika e Kosovës.

Më 31 dhjetor 2021, Kompania punëson gjithsej 21 punëtorë profesional. Kompania ka një staf të kualifikuar dhe me eksperienc shumëvjeçare në profesion.

Për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2021, struktura e pronësisë është si vijon:

- Astrit Kelmendi – individ, banor i Republikës së Kosovës, zotëron 50%,
- Sadik Berisha – individ, banor i Republikës së Kosovës, zotëron 49%, dhe
- Valbona Hamiti – individ, banor i Republikës së Kosovës, zotëron 1%.

Përderisa Bordi i Partnerëve dhe Drejtoreve të Kompanisë është në përbërje si në vijim:

- Visar Morina – Partner Menaxhues,
- Astrit Kelmendi – Kryesues i bordit,
- Sadik Berisha – Anëtar i bordit,
- Valbona Hamiti – Anëtar bordi,

Misioni dhe Vizioni

Rrjeti RSM lindh firmat anëtare përmes metodave dhe proceseve të përbashkëta, duke përfshirë standardet e përbashkëta të dakorduara dhe të aplikuara të cilësisë. Kjo lidhje siguron rehati për partnerët e firmave anëtare të RSM dhe klientët e tyre që cilësia e shërbimit dhe këshillave për klientët e referuar do të jetë në një standard vazhdimisht të lartë – kudo në botë.

RESPEKTI

TË TRAJTOJMË TË TJERËT ASHTU SIÇ DO TË DONIM TË TRAJTOHEMI

Ne tregojmë respekt në çdo komunikim me

- › Klientët
- › Punëtorët
- › Partnerët

INTEGRITETI

BËJ VEPRIMIN E DUHUR

Ne i qëndrojmë besnik besimeve tona

- › Në vendime
- › Në negociata
- › Në komunikime

PUNA EKIPORE

PUNO SË BASHKU NË MËNYRË EFEKTIVE

Ne kultivojmë bashkëpunim të mirëfilltë përmes

- › Grupeve punuese
- › Fimave anëtare
- › Funksioneve
- › Midis liderëve

PËRSOSMËRI

TË JEMI MË TË MIRËT NË GJITHQKA QË BËJMË

Ne realizojmë ndryshimin nëpërmjet

- › Standardeve tona
- › Operacioneve tona
- › Puna që dorëzojmë

MENAXHIMI

RRJETI YNË MË I MIRË, ANËTARËT DHE STAFI YNË

Ne e bëjmë RSM një vend më të mirë duke

- › Zhvilluar stafin tonë
- › Ndërtuar brendin tonë
- › Mbështetur komunitetin

Qasja Jonë

Të gjithë klientët tanë kërkojnë standarde të larta të dorëzuara në një qasje me kosto efektive. Ne krenohemi me ofrimin e shërbimeve shumë profesionale, efikase për klientët tanë dhe inkurajimin e marrëdhënieve reciproke të dobishme me klientët tanë dhe këshilltarët e tyre.

Qasja jonë përqendrohet në:

- marrjen e një qasje profesionale në shërbimet që ne ofrojmë;
- adoptimin e një qasjeje fleksibile për plotësimin e nevojave të klientit;
- pavarësinë e plotë nga lidhjet institucionale; dhe
- zhvillimin e marrëdhënieve afatgjata bazuar në themellet e forta personale që ne ndërtojmë me klientët dhe këshilltarët tanë.

Ne kemi zhvilluar një gamë të gjërë dhe fleksibile të aftësive, të cilat na lejon të shtojmë vlerë në punët e klientëve tanë duke:

- dëgjuar klientët, kuptuar objektivat e tyre dhe ofrimin e zgjidhjeve efektive dhe inovative;
- caktuar një ekip të stafit profesional, nën drejtimin e një partneri, më të përshtatshëm për aftësitë e kërkua nga klienti, mirëmbajtjen e këtij ekipi dhe rritjen e tij sipas nevojës gjatë gjithë marrëdhënieς së punës;
- respektuar dhe përmbrushur afatet dhe kërkuesat e raportimit; dhe
- ofruar tarifa reale me një strukturë fleksible të ngarkimit dhe ndihmuese në kërkimin e zgjidhjeve me kosto efektive.

Qëllimi ynë është të zhvillojmë bashkëpunim afatgjata me klientët tanë, këshilltarët dhe palët me interes që angazhojmë.



Fuqia e të qenit i Kuptuar / The Power of Being Understood


Ne ekzistojmë për të fuqizuar klientët tanë që të marrin vendime të sigurta. Për ta arritur këtë, ne përqëndrohem i rreth një mendimi të vetëm svarues – The Power of Being Understood (Fuqia e të qenit i Kuptuar). Kjo është ideja që qëndron në zemër të markës sonë dhe na udhëzon në vendimet, sjelljet, vlerat dhe veprimet tonë.

Qëllimi ynë është të japim fuqinë e të qenit i kuptuar për klientët tanë, kolegët dhe komunitetet përmes:

Bashkëpunimit



Ideve dhe njohurive



Mirëkuptimit



Ne ndërtojmë marrëdhënie të fortë, bashkëpunesë dhe qëndruese me të gjithë aksionarët duke qenë të arri shëm, të përgjegjshëm dhe të përshtatshëm.

Ne fitojmë një kuptim të thellë të nevojave, strategjive dhe aspiratave të klientëve dhe përpinqemi të jemi pjesë thelbësore e mjedisit të tyre të biznesit.

Ne i ofrojmë çdo klienti përfitimet e të menduarit të përshtatur dhe depërtimin e ekspertëve tanë, si në vend ashtu edhe globalisht.

2. Rrjeti RSM International

RSM është një rrjet ndërkombëtar i firmave profesionale të pavarura, i formuar në fillim të viteve 1960.

RSM International Limited është një kompani e kufizuar me garanci dhe është përfshirë në Angli dhe Uells (numri i kompanisë: 4040598) dhe zyra e regjistruar e së cilës është në 50, Cannon Street, London, EC4N 6JJ.

RSM International Limited nuk ofron vetë shërbime profesionale për klientët, por vepron si një organizatë e shërbimeve anëtare. Shërbimet e klientëve ofrohen nga firmat anëtare të pavarura të RSM International, secila prej firmave anëtare është një entitet juridik i veçantë dhe i pavarur. Firmat anëtare nuk janë anëtarë të një partneriteti ndërkombëtar ose partner juridik me njëri-tjetrin. Asnjë anëtar i vetëm nuk është përgjegjës për shërbimet ose veprimet e një firme tjetër anëtare. Edhe pse të

gjitha firmat anëtare të plota marrin emrin RSM, nuk ka pronësi të përbashkët midis këtyre firmave ose pronësi të tyre nga RSM International Limited.

Brendi dhe marka tregtare RSM dhe të drejtat e tjera të pronësisë intelektuale të përdorura nga anëtarët e rrjetit janë në pronësi të RSM International Association, një shoqatë e drejtuar nga neni 60 i Kodit Civil të Zvicrës, selia e të cilit është në Zug.

RSM Kosovo është anëtare e rrjetit RSM dhe operon si RSM. RSM është brend i përdorur nga anëtarët e rrjetit RSM. Çdo anëtar i rrjetit RSM është një firmë e pavarur e kontabilitetit dhe konsulencës që praktikon në vetvete.

RSM është rrjeti i gjashtë më i madh i firmave të pavarura të kontabilitetit dhe këshillimit, që përfshinë:

- firmat anëtare dhe korrespondente në 123 vende dhe janë në secilën prej 40 qendrave kryesore të biznesit në tërë botën,
- staf të përgjithshëm prej plus 51,000
860 zyre që mbulojnë Amerikën, Evropën, Lindjen e mesme, Afrikën dhe Azinë e paqësorit.

Shumë firma anëtare të RSM janë ndër shtatë vendet e para në shtetet e tyre përkatëse dhe posedojnë disa nga burimet më të mira profesionale dhe përvojën në dispozicion. Firmat anëtare kanë një bazë të gjerë klientësh nga kompani të mëdha të listuara dhe ndërkombëtare deri në bizneset më të vogla, të menaxhuara nga pronarët në sektorin publik dhe privat. Përveç shërbimeve të sigurimit tradicional, brenda RSM ka burime dhe përvojë të konsiderueshme në taksa, mbështetjen e transaksioneve, menaxhimin e riskut, auditimin e brendshëm dhe rimëkëmbjen e korporatave dhe falimentimin.

Rrjeti i **6** në nivel botoror për shërbime auditimi, tatime dhe konsulenc

qarkullim vjetor

US\$ 7.26miliard

Prezent ne

123+ vende


me

860 Zyre

me

51,000+

Staf



Kërkesat e firmave anëtare

Firmat anëtare të RSM bien dakord të miratojnë dhe përafrohen me politikat dhe procedurat e mëposhtme si kërkesë për anëtarësim

- Politikat dhe procedurat e sigurimit të cilësisë dhe përmbajtjes së rezikut të RSM;
- Manuali i Auditimit RSM;
- Politikat e Etikës dhe Pavarësisë të RSM-it;
- Trainimi i Shërbimeve të Sigurimit të RSM dhe Politikat e EVP-ve;
- Politikat dhe udhëzimet e programit të inspektimit të firmës anëtare të RSM;
- Politikat dhe udhëzimet e RSM kundër korruptionit;
- Struktura e Udhëzimit të Auditimit të Brendshëm RSM; dhe
- Struktura e Qasjes së Auditimit të Sistemeve të Informacionit RSM

Angazhimi i RSM International për cilësinë

Cilësia është gur themel absolut për RSM International dhe si e tillë çdo firmë anëtare kërcohet të përmbush një numër detyrimesh. Për të siguruar praktikat dhe standartet konsistente midis firmave anëtare, RSM International ka zhvilluar një numër të metodologjive, politikave dhe praktikave globale që janë në përputhje me Standartet Ndërkombëtare (aty ku është e aplikueshme). Këto janë zhvilluar nga specialistë dhe drejtues në firmat anëtare dhe Zyra Ekzekutive e RSM, nën mbikëqyrjen e Komitetit Ekzekutiv të Shërbimeve të Sigurimit Transnacional të RSM-it ("TASEC") dhe Bordit të Drejtorëve Ndërkombëtar të RSM.

TASEC është formuar nga partnerë senior dhe udhëheqës të tjerë nga firmat kryesore anëtare dhe është përgjegjës për mbikëqyrjen e të gjitha politikave dhe praktikave teknike të lidhura me cilësinë në të gjithë rrjetin. TASEC monitoron respektimin e politikave të tilla përmes programeve të brendshme dhe globale të inspektimit, të cilat monitorojnë kontrollin e cilësisë së secilës firmë. TASEC gjithashtu vlerëson raportet e kujdesit të duhur për firmat e reja anëtare të mundshme për të siguruar që standartet më të larta të cilësisë janë aplikuar kur pranojnë firma të reja anëtare. Komiteti raporton rekomandimet e tyre për anëtarësim tek Drejtori Ekzekutiv dhe Bordi i Drejtorëve të RSM International, përfshirë planet e veprimit për firmat e reja anëtare për të arritur objektiva cilësore brenda afateve të pranuara.

Çdo kompani anëtare është e detyruar të kryej një inspektim të brendshëm mbi cilësinë e shërbimeve të ofruara dhe përputhjen me politikat dhe procedurat e rrjetit, si dhe politikat dhe procedurat e tyre rritëse çdo vit. RSM International organizon vëzhgime globale të këtyre inspektimeve mbi baza ciklike. Nëse inspektimi vjetor i një firme ose vëzhgimet ciklike globale nxjerrin në pah mosrespektimin e konsiderueshëm, një rishikim vijues planifikohet të kontrolloj progresin në çështjet e ngritura. Mosrespektimi i konsiderueshëm mund të rezultojë në përfundimin e anëtarësisë së një firme. Cilësia është baza dhe themeli i përbashkët që na lejon të zhvillojmë dhe zgjerojmë gamën dhe thellësinë e shërbimeve të ofruara për bazën tonë të klientëve në rritje.

3. Sistemi i Kontrollit të Brendshëm

Një mesazh nga Lideri Global, i Cilësisë dhe Rezikut

Viti 2021 u karekterizua me zhvillimin e vazhdueshëm të mënyrave të reja të punës që mund të dukeshin të përkohshme gjatë ditëve të para të pandemisë, por që po bëhen gjithnjë e më të përhershme pasi që mjedisi i biznesit po transformohet. Pavarësisht sfidave të shumta që ka sjellë ky transformim, RSM mbetet e përkushtuar ndaj cilësisë në të gjitha linjat tona të shërbimit. Cilësia është themeli i rrjetit RSM dhe një themel i përbashkët për të gjitha firmat anëtare të RSM. RSM vazhdon të fokusohet në sigurimin që Firmat Anëtare të kenë metodat dhe proceset e përbashkëta të këruara për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së shërbimeve që ato ofrojnë.

Zhvillimi i RSM Orb

RSM Orb, zgjidha e auditimit e Bazuar në Rrezik Optimal e RSM, që është përkthyer në disa gjuhë, mbështet Firmat Anëtare të RSM-së në ofrimin e standardeve të larta të auditimit në mënyrë të vazhdueshme dhe është vendimtare në ofrimin e Fuqisë së të Qenurit të Kuptueshëm (The Power of Being Understood). Firmat Anëtare përdorin në mënyrë të vazhdueshme një metodologji bazë të auditimit, softver dhe mjetet tjera që mund të adaptohen për kërkuesat lokale të autoritetetve rregullatore. Në 2021, për të ngritur kualitetin, disa përmirësimi janë bërë te RSM Orb bazuar në vlerësimet e përdoruesve, veçanërisht në zhvillimin për zgjidhjen e entiteteve për "Mikro" dhe "Të fjetura". Kjo lejon auditorët e RSM-së për të kryer auditime kualitative duke u fokusuar direkt në kërkuesat e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit që janë relevante për këto entitete.

Një sistemi ri i Pavarësisë

Të qenurit i pavarur është baza themelore e RSM-së për të pasur aftësinë për të vepruar si këshilltarë të besueshëm të bizneseve. RSM ka investuar në zhvillimin e RSM InTrust, integrimin e një pavarësie globale, menaxhimin e entitetit dhe sistemin e shërbimit të autorizimit për Rrjetin e RSM-së, faza e parë që do të lansohet në Prill 2022. RSM InTrust është një përgjigje përritjen e kërkuesave rregullatore dhe do të rrisë proceset e pavarësisë të RSM globalisht. Menaxhmenti i entitetit dhe modulet e autorizimit të shërbimit do të mundësojnë informata në kohë përvendime bazuar në të dhëna duke shfrytëzuar teknologji intelegruese dhe automatike. Së fundi, do të asiston ekipet e shërbimeve të klientëve të RSM-së në identifikimin potencial në çështjet e pavarësisë, duke u përgjigjur në përpunësje me rrethanat dhe duke lëvizur përpara me besim.

Standartet Ndërkombëtare të Menaxhimit të Kualitetit (ISQMs)

RSM beson qe SNMK (ISQMs) janë baza për vazhdimësinë e transformimit të kualitetit të auditimit në këtë profesion, dhe si Zyra Globale Ekzekutive e RSM-së dhe Firmat Anëtare kanë qenë duke u përgatitur për implementimin e këtyre standardeve të reja në 15 Dhjetor 2022. Kjo vendos një sfidë të konsiderueshme për firmat

që ofrojnë shërbime sigurie, dhe Zyra Globale Ekzekutive e RSM-së ka ofruar mjetet dhe trajnimet për të ndihmuar Firmat Anëtare të RSM-së me proceset e tyre të implementimit. Këto aktivitete do të vazhdojnë përgjatë 2022 duke qenë se ne jemi duke iu afruar datës së implementimit.

Inspektimet

Pandemia e vazhdueshme bëri që, për një vit të dytë, të gjitha inspektimet e firmave anëtare dhe globale u kryen me sukses nga distanca. Ne vazhdojmë të vlerësojmë strukturën dhe përbajtjen e firmave anëtare dhe programeve të inspektimit global, veçanërisht në dritën e zbatimit të ardhshëm të ISQM 1.

Trajnimi

Në vitin 2021 ne vazhduam zhvillimin e programit mësimor të cilësisë së RSM-së, e cila qaset përmes intranetit global dhe drejtohet në sistemin global të menaxhimit të të mësuarit të RSM. Trajnimi mbi ISQM 1, Pavarësia, IFRS, Inspektimet dhe RSM Orb iu shtuan programit mësimor së cilësisë gjatë vitit.

Teknologjia

Portali i klientëve për ndarjen e skedarëve, i disponueshëm globalisht, i sigurt, i RSM, i cili plotëson portalet e ngjashme tashmë të vendosura në disa Firma Anëtare, u përdor gjerësisht pas prezantimit të tij në 2020 dhe po transformon mënyrën në të cilën Firmat Anëtare ndërveprojnë me klientët e tyre. Disa firma anëtare po udhëheqin gjithashtu përdorimin e skripteve përmarrjen e të dhënavë të klientit, të cilat thjeshtojnë mbledhjen e informacionit financiar nga libri kryesor i një klienti individual në një numër të konsiderueshëm ofruesh ERP.

Ndërsa shikojmë nga e ardhma, RSM është në procesin e vlerësimit dhe drejimit të një numri zgjidhjesh të mundshme globale të analistikës së të dhënavës, disa prej të cilave tashmë po përdoren nga firma individuale anëtare. Me mjedisin e biznesit duke u bërë gjithnjë e më kompleks, marrja e zgjidhjeve të analistikës së të dhënavës që janë të përshtatshme për t'u përdorur në të gjithë gamën e klientëve të tregut të mesëm do të jetë kyç në ofrimin e një auditimi dinamik dhe të përgjegjshëm të së ardhmes.

Profesioni i auditimit po kalon një transformim të rëndësishëm si rezultat i zbatimit të ISQM-ve, mënyrave të reja të punës, rritjes së presioneve rregullatore dhe pritshmërive për zgjidhje inovative dixhitale. RSM po i përgjigjet transformimit të profesionit tonë në mënyra të qëllimshme dhe të menduara përpara, ndërkohë që vazhdon të përmirësojë burimet dhe mjetet që u ofron firmave anëtare si pjesë e kërkimit të pafund të cilësisë së organizatës. Me të gjitha iniciativat që kemi ndërmarrë në vitin 2021, disa prej të cilave po vazhdojnë edhe në vitin 2022, kam besim në aftësinë e vazhdueshme të RSM për të kryer punë me cilësi të lartë për klientët.

"RSM po i përgjigjet transformimit të profesionit tonë në mënyra të qëllimshme dhe të menduara përpara, ndërkohë që vazhdon të përmirësojë burimet dhe mjetet që u ofron firmave anëtare."

Marion Hannon

Global Leader, Qualit and Risk

Politikat dhe Procedurat e etikës dhe pavarësisë

RSM Kosova ka krijuar sisteme dhe procedura të përshtatshme për të ndihmuar në ruajtjen e objektivitetit të stafit dhe për të shmangur konfliktin e interesit në përputhje me politikat e etikës dhe pavarësisë të aplikuara nga RSM International. Këto politika ofrojnë siguri të arsyeshme që firmat anëtare, partnerët dhe punonjësit profesionistë janë në përputhje me pavarësinë dhe kërkesat etike të :

- Bordi i standardeve ndërkombëtare të etikës për profesionistët kontabël ("Kodi BSNEPK")
- politikat, udhëzimet dhe kërkesat ndërkombëtare të RSM International,
- kërkesat tjera ligjore lokale.

Trajnimi i etikës është pjesë e procedurës së hyrjes për anëtarët e rinx të stafit.

Nga partnerët dhe punonjësit profesionalë kërkohet që çdo vit plotësimi I një pyetësori të pajtueshmërisë së pavarësisë që konfirmon se ai ose ajo:

- ka lexuar politikat e etikës dhe pavarësisë së RSM-së,
- kupton zbatueshmërinë e tyre në aktivitetet e tij / saj,
- është, dhe ka qenë për vitin e kaluar, në përputhje me ato politikat.

Çdo mos përputhje me këto politika duhet të raportohet dhe veprime korigjuse ndërmiren nga bordi i partnerëve.

Pavarësia, marrëdhëniet dhe monitorimi i konfliktit të interest

RSM mban pavarësinë, monitorimin e marrëdhënieve dhe konfliktit të interest duke përdorur aplikacionin Ndjekësi Global i Marrëdhënieve(GRT). Firmave anëtare u kërkohet të përdorin GRT për të renditur klientët të shërbimeve audituse dhe jo audituse për kategoritë e mëposhtme:

- subjektet e interesit publik, përfshirë entitetet e listuara, subjektet private me pronësi ose bashkëpunëtorë të vendosur në një juridiksion tjeter ose një vend, përfshirë perfituesin e fundit, kompaninë mëmë të ndërmjetme, motra ndërmarrje, filiale ose bashkëpunëtorë,
- grupet ose fondet e kapitalit privat.

Për më tepër, të gjithë klientët që janë filialë ose bashkëpunëtorë të grupeve plotësimi i kritereve të mësipërme kërkohet të përfshihen në GRT.

Partnerët dhe punonjës profesionalë të firmës kërkohet që të konsultohen me GRT dhe të marrin masa të tjera paraprake që konsiderohen të nevojshme në rrethana për të siguruar pajtueshmërinë me etikën dhe politikat e pavarësisë së RSM.

Procesi i zgjedhjes së konflikteve

Kur partneri i firmës anëtare ose punonjësi profesional identifikon një rrezik të mundshëm të pavarësisë ose konflikt interesit në lidhje me një klient ose klient të ardhshëm të një anëtari tjeter, firma përmes kërkimeve në GRT dhe kontrolleve të tjera të konfliktit të interesave, partneri ndërkombëtar i kontaktit (ICP) i firmës anëtare duhet të informohet.

Nëse firmat anëtare nuk janë në gjendje të bien dakord për masat mbrojtëse të përshtatshme, zyra ekezkutive globale (GEO) dhe Kryetari i Bordit kërkohet të marrin në konsideratë démtimin e mundshëm të pavarësisë ose konflikti i interesit. Firmat anëtare duhet të jalin GEO informacionin e nevojshëm në lidhje me faktet dhe rrëthanat përkatëse, cilat do të përdoren për të vlerësuar démtimin e mundshëm të pavarësisë ose konflikti të interesit. GEO dhe Kryetari i Bordit, pasi të keni shqyrtau kërkesën dhe informacionin e dhënë, bëjnë një rekomandim për zgjidhjen e démtimit të mundshëm të pavarësisë ose konfliktit të interesit.

Pranimi dhe vazhdimi i relacioneve me Klientë

Sigurimi i shërbimeve të auditimit me cilësi të lartë kërkon që RSM firmat anëtare pranojnë vetëm klientë që ndajnë thelbin e RSM në vlerat dhe besimet. RSM Kosova hynë vetëm në marrëdhëniet me klientët që përshtaten me kriteret kryesore të pranimit të RSM dhe të cilët janë të përgatitur të paguajnë një tarifë të drejtë për punën me vlera të larta.

Gjatë procesit të pranimit të klientëve partneri i angazhimit vlerëson nivelin e rrezikut të angazhimit dhe përcakton në qoftë se kërkesa speciale për personel, mbikëqyrje dhe rishikim duhet të angazhohen. Një partner i dytë kërkohet të pajtohet me pranimin e klientit, nëse plotëson profile të caktuara të rrezikut.

Metodologjja e Auditimit –RSM Orb

Cilësia është gur themeli absolut për RSM. Për të forcuar mesazhin që cilësia e auditimit ka një rëndësi të madhe në RSM , GEO duke punuar së bashku me disa firma anëtare më të mëdha ka zhvilluar metodologjinë e auditimit RSM Orb, që bazohet në rrezik. Përbëhet nga katër elementë:

- metodologjia e specializuar globale e auditimit,
- manuali global i auditimit,
- forma të RSM të vendosura në një softuer të licencuar,
- udhërrëfyesi.

RSM Orb përfshin kërkesa për kontrollin e cilësisë së angazhimit dhe konsultime të detyrueshme me Partnetin e Auditimit, Shefin e Etikës dhe Pavarësisë ose një partner tjeter i kualifikuar, sipas rastit.

RSM Orb përpushtet me kërkesat e mëposhtme:

- standardet ndërkombëtarë të kontrollit të cilësisë të lëshuara nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit dhe Sigurimit,
- standardet ndërkombëtarë të auditimit të lëshuara nga Bordi i Standardeve

- Ndërkombejtare të Auditimit dhe Sigurimit (IAASB),
- deklaratat e praktikës ndërkombejtare të auditimit të lëshuara nga IAASB,
 - sigurimi i cilësisë së RSM dhe politikat e kontrollit të riskut.

Matja e cilësisë

Treguesit e cilësisë së auditimit

Firma janë ndjek një seri të treguesve të cilësisë së auditimit të përdorur gjérësish nga rrjeti RSM; ne kemi përfshirë masa për të njëjtat tema gjatë gjithë raportit.

- Shqyrtimë të brendshme të cilësisë: Dosjet tona të auditimit i nënshtronen rishikimeve të brendshme të cilësisë dhe përfshijnë rishikimin e auditimeve të subjekteve me interes publik, kur është e përshtatshme.
- Trajnim: Ne jemi të përkushtuar për trajnime dhe investojmë kohë të konsiderueshme në trajnimin e stafit për ta rritur cilësinë e auditimit.
- Investimi në kërkime dhe zhvillim: duke investuar shumë në zhvillimin e kurseve tona të brendshme, ne jemi në procesin e prezantimit të një metodologje të re globale të auditimit me firmat e tjera RSM International në përpunje me zhvillimet e fundit në Standartet Ndërkombejtare të Auditimit dhe praktikave të auditimit.
- Teknologjia: Ne jemi të përkushtuar të investojmë në teknologji për të arritur një auditim cilësor dhe efikas. Mjete për auditim, analitikë, shpalosje të pasqyrave financiare, përgatitje të pasqyrave financiare dhe menaxhim të kohës.
- Vlerësimi i drejtoreve dhe stafit: Ne inkurajojmë vlerësimin dhe kontributin e vazhdueshëm nga të gjithë anëtarët e stafit. Në vlerësimin e perfomancës së stafit ne e potencojmë që cilësia e auditimit mbetet në krye të axhendës dhe sigurohemi që stafi dhe drejtoret kanë, kohën dhe trainimin e duhur për të ofruar auditime cilësore.

Monitorimi i jashtëm dhe i brendshëm i cilësisë

Këshilli Kosovar për Raportim Financiar dhe Shoqata e Kontabilistëve të Çertifikuar dhe Auditorëve të Kosovës (ShKÇAK) bëjnë monitorimin e cilësisë së auditimit të firmave dhe antarëve të shoqatës.

Gjatë vitit 2018, shoqata ka rishikuar cilësinë e auditimit të antarëve të saj dhe raporti i vlerësimit nga shoqata ka qenë pozitiv.

Në përpunje me politikën RSM Global dhe ISQC 1, Firma ka kryer një vetë-inspektim në Nëntor 2021. Inspektimi përfshin një rishikim të një mostre të dosjeve të auditimit. Raporti i inspektimit u dërgua në RSM Global dhe nuk kishte komente të mëtejshme. Inspektimi nga Global RSM u performua ne shtator te vitit 2020. Bordi është i përfshirë ngushtë me të gjitha vizitat rregullatore dhe shqyrton në mënyrë të detajuar të gjitha gjetjet dhe rekomandimet.

Trajinimet dhe proceset tona janë nën rishikim të vazhdueshëm për të siguruar që auditimet tona janë me cilësimë të lartë. Janë ndërmarrë veprime për të adresuar fushat për përmirësimin e sugjeruar të identifikuar në raportet e inspektimit. Ne vazhdojmë t'i përgjigjemi shqyrtimëve të fundit dhe praktikës më të mirë aktuale. Progresi në zbatimin e këtyre veprimeve është, dhe do të vazhdojë të monitorohet nga Bordi.

Rezultatet e rishikimeve

Rishikimet ndodhin çdo vit si pjesë e Programit tonë të Kontrollit të Firmave Anëtare. Çdo tre vite, inspektimi realizohet nga RSM International. Rishikimi arrin një mbulim të arsyeshëm të dosjeve, rishikimet e dosjeve të Sigurimit të Cilësisë ("QA") përfshijnë një përzierje të llojeve dhe madhësive klientit, përfshirë auditimet e ndryshme të specializuara si bankat dhe kompanitë e sigurimeve.

Koordinatori i Inspektimit i paraqet çdo vit Bordit gjetjet e inspektimit, i cili përcakton çdo shqetësim aktual dhe marrjen e përgjigjeve dhe veprimeve të menjëherëshme sipas nevojës. Një raport që përfshin këto gjetje dhe planin e veprimit i paraqitet RSM Global.

4. Edukimi i vazhdueshëm Profesional, Rekrutimi dhe Zhvillimi Personal

Edukimi i vazhdueshëm profesional

Partnerët përgjegjës dhe stafi i RSM Kosovo sh.p.k janë anëtar në Shoqatën e Kontabilistëve dhe Auditorëve të Çertifikuar të Kosovës (SCAAK), përkatesisht anëtar të "Association of Chartered Certified Accountants (ACCA)".

Gjatë këtij viti, Shoqata e Kontabilistëve të Certifikuar dhe Auditorëve të Kosovës ka zhvilluar disa sesione të edukimit të vazhdueshëm professional mbi SNRF dhe

riperditësimet e auditimit. Gjithashtu dhe stafit u sigurohet trajnim i

mëtutjeshëm sipas roleve specifike dhe fushave të specializmit.

Si pjesë e programit të EVP-së, Menaxherët dhe stafi gjithashtu ndjekin kurse në fusha për të përmirësuar cilësinë e auditimit, pasi ne e pranojmë që nivele të larta të aftësive në këto fusha ndihmojnë për të siguruar që auditimet të funksionojnë në mënyrë të qetë dhe efektive dhe njohuritë teknike përkatëse mund të zbatohen në fazat e duhura të auditimit.

Rekrutimi

Përmes politikave dhe proceseve tona të rekrutimit dhe trajnimit, ne sigurohemi që të térheqim individë të talentuar dhe t'u sigurojmë atyre zhvillim dhe aftësi që u duhen për të përbushur një karrierë të gjatë dhe të përkushtuar me RSM.

Praktika jonë e rekrutimit siguron që ne të arrijmë në sa më shumë individë të talentuar, si dhe përmes punësimit direkt. Metodologjitetona të përzgjedhjes përqendrohen në vlerësimin e gamës së plotë të aftësive dhe cilësive që besojmë se janë thelbësore për të pasur sukses si auditor në RSM.

Ne jemi gjithmonë në kërkim të anëtarëve të talentuar, të kualifikuar dhe me përvojë të stafit.

Vlerësimi

Ne kemi investuar kohë dhe energji të konsiderueshme për të siguruar që punonjësit tē dinë se çfarë pritet prej tyre në çdo fazë të karierës së tyre, në mënyrë që ata tē dinë se si tē përparojnë. Të kesh kompetenca tē qarta për stafin në çdo nivel gjithashtu do tē thotë që klientët tanë mund tē sigurohen për të njëjtin nivel shërbimi, pavarësisht nga vendndodhja. Çdo punonjës ka reagime dhe vlerësimë të rregullta. Firma kryen një vlerësim të fundvitit për të rishikuar progresin e objektivave të përcaktuara në vlerësimin e fundvitit. Cilësia e auditimit është në themel të secilit vlerësim.

EVP-të e ndjekura dhe progresi ekzaminues i individit, sipas rastit, gjithashtu diskutohen gjatë vlerësimit.

Promovimet rekondohen nga Kryesuesi i

Departamentit. Bordi vlerëson reportin e dhënë nga drejtesi i departamentit përkatës për individët në fjalë.

Zhvillimi personal

Zhvillimi i njerëzve tonë është diçka për të cilën RSM është e apasionuar. Ne ofrojmë një gamë të gjerë të kurseve të zhvillimit personal, të cilat janë krijuar për të mbështetur individët ndërsa përparojnë gjatë karrierës së tyre.

Ne ofrojmë një shumëllojshmëri kursesh që lejojnë punonjësit të përshtatin zhvillimin e tyre bazuar në nevojat e tyre personale si në rolin e tyre aktual ashtu edhe pasi ato përparojnë përmes roleve të ndryshme gjatë karrierës së tyre.

Kompania është e përkushtuar tē zhvillojë një kulturë mentorimi dhe tē mbështesë mentorët dhe anëtarët tanë tē rinjë për ta bërë këtë marrëdhënie të funksionoj. Ne besojmë se tē gjithë meritojnë tē kenë dikë në biznes përveç menaxherit tē tyre tē linjës që udhëzon dhe mbështet udhëtimin e tyre në karrierë.

Trajnimi është thelbësor për zbulimin e potentialit në stafin tonë për tē maksimizuar performancën e tyre dhe për tē kontribuar në suksesin e ardhshëm tē Kompanisë. Për tē arritur këtë, ne marrim përsipër trajnime në punë për tē ndërtuar aftësi dhe shkathtësi në rolet ekzistuese, zhvillojmë trajnime për tē mbështetur përparimin e ardhshëm dhe trajnimin e sjelljes për tē arritur një ndryshim afatëgjatë domethënës përmes rritjes së vetëdijësimit.

Ekzistojnë mundësi zëvendësimi në dispozicion tē punonjësve në mënyrë që ata tē arrijnë një thelli më tē madhe përvoje dhe kuptimi tē industriisë dhe biznesit tonë, të cilat mund tē nxirren pas kthimit të tyre.

5. Kompensimi i Partnerëve

Është besimi ynë i palëkundur se cilësia e auditimit përmirësuhet më së miri duke implikuar tek Partnerë etikën se cilësia e auditimit është në thelb të gjithçkaje që ne bëjmë.

Partnerët dhe drejtorët e Kompanisë shpërblehen me paga dhe pjesë tē bonusit, kjo e fundit përcaktohet duke iu referuar vlerësimit i cili është i lidhur me kriteret e cilësisë së auditimit si në rishikimin e performancës së kaluar, ashtu edhe në objektivat për vitin e ardhshëm.



6. Auditimi i subjekteve me interes publik

RSM Kosovo gjatë vitit finanziar 2021 ka kryer auditimet e mëposhtme të pasqyrave financiare të subjekteve me interes publik.

Nr.	Emri i klientit	Industria	Për vitin e përfunduar
1	Hib Petrol Sh.p.k	Tregti dhe shërbime	31 dhjetor 2020
2	Buçaj Sh.p.k.	Tregti dhe shërbime	31 dhjetor 2020
3	Birra Peja Sh.a	Prodhim	31 dhjetor 2020
4	Korporata Energjitime e Kosoves Sh.a	Energi	31 dhjetor 2020
5	Operatori Sistemi, Transmisioni dhe Tregu - KOSTT SH.A	Energi	31 dhjetor 2020
6	KS Prisig Sh.a	Kompani të sigurimeve	31 dhjetor 2020
7	KSSiguria Sh.a	Kompani të sigurimeve	31 dhjetor 2020
8	KS Scardian Sh.a	Kompani të sigurimeve	31 dhjetor 2020
9	KS Dukagjini Sh.a	Kompani të sigurimeve	31 dhjetor 2020
10	KS Illyria Sh.a	Kompani të sigurimeve	31 dhjetor 2020
11	KS Illyria Life Sh.a	Kompani të sigurimeve	31 dhjetor 2020
12	Fondi Sloveno – Kosovar i Pensioneve Sh.a	Fonde pensionale	31 dhjetor 2020
13	Fondi I Kursimeve Pensionale të Kosovës	Fonde pensionale	31 dhjetor 2020

*Shpalosja në përpunje me nenin 10, paragrafi 5.6 iligjit nr. 06/L –032 për Kontabilitet, Raportimin Financiar dhe Auditim.

7. Shënimet Financiare


Në tabelen më poshtë janë të prezantuara të hyrat e Kompanisë të realizuara gjatë vitit 2021:

	2021 (EUR)
Shërbimet e auditimi- (Jo SiP), sherbime tjera te sigurise dhe sherbime te nderlidhura	220,167
Shërbimet e auditimi - (SIP)	149,630
Shërbimet e kontabilitetit, taksave dhe konsulencës	155,240
	525,037



7.Deklaratë e Bordit të Partnerëve për efektivitetin e funksionimit të sistemit të kontrollit të cilësisë

RSM Kosovo Sh.p.k konfirmon që sipas njohurive dhe besimit më të mire të tyre, sistemi i kontrollit të cilësisë ka operuar në mënyrë efektive gjatë vitit që përfundoi më 31 dhjetor 2021 për të siguruar siguri të arsyeshme se angazhimet e sigurimit janë në përputhje me kërkuesat ligjore, rregullatore dhe profesionale të zbatueshme.



Visar Morina
Partner Menaxhues



Astrit Kelmendi
Kryetar i Bordit

SHTOJCA

Deklarata e pavarësisë

Deklarata e sistemit të
kontrollit të brendshëm


Deklarata mbi edukimin e
vazhdueshëm profesional



DEKLARATA E PAVARËSISË

RSM Kosovo Sh.p.k., deklaron se operon në përmbushje me të gjitha kriteret që lindin nga Kodi i Etikës dhe Sjelljes Profesionale i lëshuar nga Federata Ndërkombe të Kontabilistëve.

RSM Kosovo Sh.p.k. është anëtare e rrjetit te RSM International ku është e domosdoshme që të përmbush dhe të respektojë të gjitha kriteret që dalin nga Politikat e Etikës dhe Pavarësisë të RSM.

A handwritten signature in blue ink, appearing to read "Morina" with a small "22" written above it.


Visar Morina
Partner Menaxhues

A handwritten signature in blue ink, appearing to read "Kelmendi".

Astrit Kelmendi
Kryetar i Bordit

DEKLARATA E SISTEMIT TË KONTROLLIT TË BRENDSHËM

RSM Kosovo Sh.p.k., deklaron se gjatë vitit 2021 ka përmbushur të gjitha kriteret që lindin nga politikat dhe procedurat lidhur me sigurimin e cilësisë.



Visar Morina
Partner Menaxhues




Astrit Kelmendi
Kryetar i Bordit

DEKLARATA MBI EDUKIMIN E VAZHDUESHËM PROFESIONAL

Partnerët përgjegjës të departamentit të auditimit dhe stafi në RSM Kosovo Sh.p.k janë anëtar në Shoqatën e Kontabilistëve dhe Auditorëve të Çertifikuar të Kosovës (SCAAK), përkatësisht anëtar të "Association of Chartered Certified Accountants (ACCA)".

Prandaj, RSM Kosovo Sh.p.k., deklaron se gjatë vitit 2021 ka përmbrushur të gjitha kriteret që lindin nga politikat dhe procedurat lidhur me edukimin e vazhdueshëm profesional për partnerët dhe stafin kyq të auditimit.



Visar Morina
Partner Menaxhues



Astrit Kelmendi
Kryetar i Bordit

THE POWER OF BEING UNDERSTOOD
AUDIT|TAX|CONSULTING

RSM Kosovo Sh.p.k is a member of the RSM network and trades as RSM. RSM is the trading name used by the members of the RSM network. Each member of the RSM network is an independent accounting and consulting firm which practices in its own right. The RSM network is not itself a separate legal entity in any jurisdiction.

The RSM network is administered by RSM International Limited, a company registered in England and Wales (company number 4040598) whose registered office is at 50 Cannon Street, London EC4N 6JJ.

The brand and trademark RSM and other intellectual property rights used by members of the network are owned by RSM International Association, an association governed by article 60 et seq of the Civil Code of Switzerland whose seat is in Zug.

© RSM International Association

www.rsmglobal.com\kosovo

